**VENDIM**
**Nr. 372, datë 20.6.2018**

# PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË KULTURËS DHE REVOKIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË BASHKISË TIRANË, PËR SIPËRFAQEN PREJ 235 $m^2$, TË PASURISË ME NUMËR 1/256, ME SIPËRFAQE TOTALE 1644 $m^2$, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8150

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 12, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe shkronjës "a", të nenit 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, për sipërfaqen prej 235 $m^2$ të pasurisë me numër 1/256, me sipërfaqe totale 1644 $m^2$, me vendndodhje në zonën kadastrale 8150, me qëllim zhvillimin e projektit "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor", sipas hartave treguese që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 760, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të disa pronave me vendndodhje në zonat kadastrale 8250, 8240, 8190, 8150", sipërfaqja e pasurisë përmendur, në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet 1409 $m^2$.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Senida Mesi**

SH. 1:2000


ISH PALLATI I KULTURËS
SHESHI "SKËNDERBEJ"
RRUGA "LUIGJ GURAKUQI"
RRUGA "28 NËNTORI"
RRUGA "ABDI TOPTANI"
RRUGA "MURAT TOPTANI"

FRAGMENT NGA PLANIMETRIA E TIRANËS, ZK. 8160, TR; O-12, VITI 2018, SH.1:500

Porositës D.P.J.A.L, BASHKIA E TIRANËS
Nr. Prot 11988, Datë 26/03/2018




SHËNIME

GEN-PLANI SHOQËROHET GJITHMONË ME FRAGMENTIN E HARTËS NË SHKALLË 1:2000

PJESA E RRJETËZUAR DHE ME VIJË TË NDËRPRERË ËSHTË PJESA E AZHORNUAR NË TERREN

REFERUAR CERTIFIKATËS, KARTELËS SË PASURISË DHE HARTËS TREGUESE TË REGJISTRIMIT, BASHKËLIDHUR SHKRESËS ME NR. PROT. 11988

DATË 26.03.2018, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË JURIDIKUT E ASETEVE DHE LIÇENSIMIT, DREJTORIA E PASURIVE TË PALUAJTSHME.

PJESA E AZHORNUAR NDODHET BRENDA PASURISË ME NR. 1/356, ZONA KADASTRALE 8160, ME NOMENKLATURË TR. O-12, VOL. 31, FQ. 41, ME

LLOJIN E PASURISË "RRUGË", ME GJENDJEN JURIDIKE "BASHKIA TIRANË"

KËRKESA PËR AZHORNIM ËSHTË PËR SIPËRFAQEN PREJ 235 M2, E KONTURUAR NË FRAGMENTIN E HARTËS KADASTRALE BASHKËLIDHUR

SHKRESËS SË MËSIPËRME

| | | | |
|---|---|---|---|
| REPUBLIKA E SHQIPËRISË<br>BASHKIA E TIRANËS | DREJTOR I KADASTRËS | ENDRIT SHTISHI | |
| DREJTORIA E KADASTRËS | PËRGJ. SEKTORIT TË KADASTRËS URBANE | MERITA QIRJAKO | |
| Datë: 26/03/2018 | AZHORNOI | AUREL XHOVELI | |